

RUBRIKA I
E DREJTA KUSHTETUESE DHE TË DREJTAT E NJERIUT

Teza 2

I. Rrethoni alternativën e saktë

1. Çfarë janë detyrimet e shtetit gjatë ushtrimit të një tubimi paqësor:

- a) Asnjë detyrim;
- b) Negative;
- c) Pozitive;
- d) Negative dhe pozitive.

2. Parimi i proporcionalitetit ka të bëjë me:

- a) Zbatimin e përpiktë të legjislacionit në fuqi;
- b) Përdorimin e mjeteve të përshtatshme dhe në balancë me qëllimet që synohen të arrihen;
- c) Trajtimin e barabartë të të gjitha subjekteve para ligjit;
- d) Zbatimin me efektivitet të ligjit.

3. Cili prej akteve që vijojnë ka fuqi më të lartë juridike në Shqipëri:


- a) Marrëveshja e Stabilizimit-Asociimit me BE-në;
- b) Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike i OKB-së;
- c) Karta Sociale Europiane;
- d) Konventa Europiane për të Drejtat e Njeriut.

4. Emërimi dhe shkarkimi i ministrave të veçantë bëhet nga:

- a) Kuvendi me propozim të Këshillit të Ministrave;
- b) Presidenti me propozim të Kuvendit;
- c) Presidenti me propozim të Kryeministrit;
- d) Kryeministri me propozim të Presidentit.

5. Ratifikohen detyrimisht me ligj marrëveshjet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me:

- a) edukimin;
- b) artin;
- c) sportin;
- d) territorin.



6. Miratohet me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit ligji për:

- a) taksat dhe tatimet;
- b) ndarjen administrative të Republikës;
- c) buxhetin e shtetit;
- d) arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë.

7. Kuvendi mbledhet në sesion të jashtëzakonshëm kur kërkohet nga:

- a) Çdo deputet;
- b) Avokati i Popullit;
- c) Kryetari i Kuvendit;
- d) Kryeministri.

8. Nisma legjislative i takon:

- a) Presidentit të Republikës;
- b) Kryeministrit;
- c) Deputetit;
- d) Ministrit.

9. Anëtari i Këshillit të Lartë Gjyqësor shkarkohet nga:

- a) Kuvendi;
- b) Presidenti i Republikës;
- c) Gjykata Kushtetuese;
- d) Gjykata e Lartë.

10. Kuvendi zgjedh gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese me:

- a) jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij;
- b) jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij;
- c) me të paktën shumicën e të gjithë anëtarëve të tij;
- d) me të paktën shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij.



RUBRIKA II
E DREJTË ADMINISTRATIVE – E DREJTË PUNE
TEZA 11

I. Gjени përgjigjen e saktë:

E DREJTË ADMINISTRATIVE

11. Sipas Kodit të Procedurave Administrative:

- a) përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, procedura administrative kryhet në gjuhën dhe shkrimin shqip;
- b) nëse pala duhet të paraqesë një kërkesë brenda afatit dhe e bën këtë në një gjuhë të huaj, organi publik nuk ka asnjë detyrim për të njoftuar palën për ta paraqitur kërkesën në gjuhën dhe shkrimin shqip;
- c) nëse pala që duhet të paraqesë një kërkesë brenda afatit e bën këtë në një gjuhë të huaj, konsiderohet se kërkesa nuk është paraqitur në afat;
- d) nuk ka asnjë rast kur kërkesat lejohet të paraqiten në gjuhë të huaj, sepse në vendin tonë gjuha zyrtare është ajo shqipe.

12. Akti individual i Këshillit të Ministrave fillon të sjellë pasoja juridike:

- a) kur i njoftohet përmbajtja e tij personit konkret;
- b) kur botohet në Fletoren Zyrtare;
- c) ditën e nxjerrjes së aktit;
- d) në datën e caktuar shprehimisht nga vetë akti, pavarësisht se pala nuk është njoftuar më parë.

13. Në cilat raste mund të mos dëgjohej pala e interesuar në një procedurë hetimore administrative:


- a) kur prek, apo cenon të drejtat dhe interesat e ligjshme të palës;
- b) kur ka një ankim nga pala e interesuar;
- c) në një procedurë administrative që bazohet në një procedurë konkurruese publike;
- d) palët nuk kanë paraqitur paraprakisht mendimet, komentet dhe shpjegimet e plota për procedurën administrative.

14. Nuk përfshihen në përkufizimin e organit publik sipas Kodit të Procedurave Administrative:

- a) Gjykatat gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre gjyqësore;
- b) Personat fizikë të cilëve u është dhënë me ligj, akt nënligjor ose çdo lloj forme tjetër, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, e drejta e ushtrimit të funksioneve administrative publike;
- c) Entet publike në masën që kryejnë funksione administrative;
- d) Organet e qeverisjes qendrore për aq sa kryejnë funksione publike.

15. Gjatë gjykimit incidental, gjykata administrative:

- a) kryesisht vendos të mos zbatohet një akt nënligjor normativ, në bazë të të cilit është kryer veprimi administrativ që shqyrtohet, kur çmon se akti nënligjor është i paligjshëm;
- b) vendos të zbatohet aktin nënligjor normativ, në bazë të të cilit është kryer veprimi administrativ që shqyrtohet, megjithëse në arsyetim vlerëson se akti nënligjor është i paligjshëm, por nuk është në kompetencën e saj;
- c) ia dërgon për shqyrtim Gjykatës Administrative të Apelit si gjykata kompetente për shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve normative;
- d) ia dërgon për shqyrtim Gjykatës Kushtetuese, si e vetmja gjykatë kompetente.



16. Sipas LGJA-së:

- a) Pala, kundër të cilës është bërë rekurs, mund të paraqesë kundërrekurs brenda 30 ditëve nga komunikimi i rekursit.
- b) Mosparaqitja e kundërrekursit brenda afatit ligjor nuk sjell humbjen e së drejtës për të paraqitur pretendimet në një fazë të mëvonshme në Gjykatën e Lartë.
- c) Shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë bëhet vetëm mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi;
- d) Kur rekursi nuk plotëson kushtet formale dhe nuk është nënshkruar nga avokati, gjyqtari i vetëm ose relatori që ka dhënë vendimin njofton palën që të ndreqë të metat brenda 5 ditëve.

17. Gjykata administrative e shkallës së parë, në vendimin e saj përfundimtar të pranimit, tërësisht ose pjesërisht të padisë:

- a) vendos vetëm shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ;
- b) konstaton paligjshmërinë e veprimit administrativ që nuk prodhon më pasoja juridike, nëse paditësi ka një interes të arsyeshëm për këtë;
- c) përcakton organin që ka në kompetencën e tij zgjidhjen e çështjes konkrete, duke i kërkuar organit jo kompetent të shfuqizojë aktin e nxjerrë;
- d) nuk ka detyrim të shprehet për ligjërimin e masës së sigurimit të padisë.

E DREJTË PUNE

18. Punëmarrësi nuk mund të heqë dorë nga të drejtat, që rrjedhin nga:

- a) dispozitat e kontratës kolektive të punës;
- b) marrëveshjet e bëra në prani të inspektorit të punës ose në formën e parashikuar në kontratën kolektive të punës, pavarësisht qëllimit të tyre;
- c) një marrëveshje që ka për qëllim zëvendësimin e pushimeve vjetore me pagesë;
- d) kontrata individuale e punës sipas përcaktimeve të legjislacionit të punës.

19. Kur greva nuk është e ligjshme punëdhënësi ka të drejtë:

- a) të zgjidhë kontratën e punës me efekt të menjëhershëm ndaj punëmarrësve që nuk fillojnë punën brenda dy ditëve;
- b) të zëvendësojë punëmarrësit të cilët janë të përfshirë në grevë;
- c) t'i kërkojë shlyerjen e dëmit të shkaktuar sindikatës që ka organizuar grevën;
- d) asnjë nga alternativat e mësipërme.

20. Punëdhënësi mund të kërkojë zbatimin e marrëveshjes për ndalimin e konkurrencës vetëm nëse i ofron punëmarrësit, gjatë periudhës së ndalimit:

- a) jo më pak se 50% të pagës që ai do të merrte po të vazhdonte punën për punëdhënësin;
- b) jo më pak se 75% të pagës që ai do të merrte po të vazhdonte punën për punëdhënësin;
- c) jo më pak se 90% të pagës që ai do të merrte po të vazhdonte punën për punëdhënësin;
- d) jo më pak se 80% të pagës që ai do të merrte po të vazhdonte punën për punëdhënësin.



RUBRIKA III
E DREJTË PENALE – PROCEDURË PENALE
TEZA 4

I. Rrethoni alternativën e saktë:

E DREJTË PENALE

- 21. A duhet të ketë përfunduar sulmi i padrejtë i sulmuesit ndaj të gjykuarit, që ky i fundit të vlerësohet se ka vepruar në kushtet e mbrojtjes së nevojshme?**
- Sulmi duhet të jetë iminent, të ketë nisur apo të mos ketë përfunduar që të pranohet se i gjykuari ka kundërvepruar në kushtet e mbrojtjes së nevojshme;
 - Nëse pasojat janë të dukshme, edhe kur sulmi ka përfunduar, veprimet e të gjykuarit mund të vlerësohen si të kryera në kushtet e mbrojtjes së nevojshme;
 - Mjafton që i gjykuari të ndiejë rrezikun që personi do ta sulmojë dhe vepron vetë i pari, pa pritur reagimin e tij, kjo përbën bazë për të kërkuar mbrojtjen e nevojshme;
 - Mosnjsja e sulmit përbën pengesë ligjore që i gjykuari të kërkojë zbatimin e këtij shkaku justifikues të përgjegjësisë penale.
- 22. A mund të dënohet penalisht një person nëse ka kryer veprën nën urdhrat e paligjshëm të dhënë nga eprori i tij?**
- Urdhri i paligjshëm i dhënë sipas hierarkisë nuk përjashton personin që e zbaton atë nga përgjegjësia penale;
 - Për urdhrin e paligjshëm nuk mban përgjegjësi autori, por eprori i tij;
 - Zbatimi i urdhrit të paligjshëm ngarkon me përgjegjësi vetëm autorin material të kryerjes së veprës penale, në zbatim të parimit të individualizimit të dënimit penal;
 - Personi që zbaton një urdhër të paligjshëm nuk mund të ngarkohet me përgjegjësi penale, pasi në veprimet e tij mungon dashja, si element i domosdoshëm i anës subjektive të veprës penale.
- 23. A është numri i personave që marrin pjesë në kryerjen e veprës penale ndikues për gjykatën në përcaktimin e masës së dënimit ndaj tyre?**
- Gjykata vendos dënimin vetëm duke u bazuar në rëndësinë e veprës dhe parashikimin në ligj të masës e llojit të dënimit përkatës;
 - Numri i personave që marrin pjesë në kryerjen e një vepre ndikon në masën e dënimit penal të dhënë nga gjykata, sepse lidhet me rrezikshmërinë e veprës dhe të autorëve të saj;
 - Caktimi i dënimit merr parasysh tregues individualë të autorëve dhe nuk lidhet me numrin e tyre;
 - Vetëm kur numri i pjesëmarrësve është mbi tre, kjo rrethanë mund të ndikojë në caktimin e një dënimi më të rëndë.
- 24. Juridiksioni universal është i zbatueshëm edhe për shtetasin e huaj që ndodhet në Republikën e Shqipërisë dhe nuk është ekstraduar, i cili jashtë territorit të Shqipërisë ka kryer, veprën penale:**
- të trafikimit të njerëzve;
 - të pastrimit të produkteve të veprës penale;
 - të krimit të korrupsionit aktiv e pasiv;
 - me qëllime terroriste



RUBRIKA IV
PROCEDURË CIVILE DHE E DREJTË CIVILE
TEZA 18

I. Rrethoni alternativën e saktë:

PROCEDURË CIVILE

31. Gjени fjalinë e saktë:

- a) Njoftimi i akteve të shtetit të huaj bëhet në çdo rast nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë;
- b) Njoftimi i akteve të shtetit të huaj, në raste të veçanta bëhet drejtpërdrejt midis organeve kompetente të dy shteteve;
- c) Akti i shtetit të huaj i njoftohet personit që i dërgohet në gjuhën e vendit nga i cili është dërguar dhe marrësi që nuk njeh gjuhën në të cilën është përpiluar, nuk ka të drejtë të refuzojë njoftimin dhe të kërkojë që akti të përkthehet në gjuhën shqipe, ose në një gjuhë tjetër të njohur prej pritësit;
- d) Ekzekutimi i një kërkesë për njoftim akti nuk mund të refuzohet nga autoritetet kompetente shqiptare.

32. Gjени fjalinë e saktë:

- a) Kërkesëpadia mund të mos përmbajë vlerën e padisë;
- b) Kërkesëpadia mund të mos përmbajë kërkimin e paditësit;
- c) Kërkesëpadia mund të mos përmbajë objektin e padisë;
- d) Kërkesëpadia mund të mos përmbajë shkakun ligjor të padisë.

33. Gjени fjalinë e saktë:

- a) Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit mund të paraqitet nga pala, vetëm në seancën e veprimeve përgatitore;
- b) Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit mund të paraqitet nga pala, vetëm në seancën e parë gjyqësore, pas shpalljes së përbërjes së trupit gjykues;
- c) Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit mund të paraqitet nga pala në çdo fazë të gjykimit të çështjes;
- d) Kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit nuk mund të paraqitet nga pala në gjykimin në gjykatën e Apelit apo në gjykimin në Gjykatën e Lartë.

34. Gjени fjalinë e saktë:

- a) Eksperti e jep mendimin e tij vetëm me shkrim;
- b) Eksperti e jep mendimin e tij vetëm me gojë;
- c) Eksperti e jep mendimin e tij me shkrim, por mund të dëgjohet në seancë gjyqësore dhe të pyetet nga gjykata dhe nga palët;
- d) Eksperti e jep mendimin e tij me gojë, por mund t'i kërkohet mendimi me shkrim në seancë gjyqësore, sipas pyetjeve të bëra nga gjykata dhe nga palët.



35. Gjenerali i saktë:

- a) Kundër vendimit me të cilin vendoset pezullimi ose pushimi i gjykimit, mund të bëhet ankimi brenda 15 ditëve në Gjykatën e Apelit;
- b) Kundër vendimit me të cilin vendoset pezullimi ose pushimi i gjykimit, mund të bëhet ankimi brenda 5 ditëve në Gjykatën e Apelit;
- c) Kundër vendimit me të cilin vendoset pezullimi ose pushimi i gjykimit, nuk lejohet ankimi;
- d) Afati i ankimit kundër vendimit të pezullimit ose pushimit të gjykimit fillon nga e nesërmeja e shpalljes së vendimit.

E DREJTË CIVILE

36. A mund të lidhet kontrata e dhurimit me kusht?

- a) Kontrata e dhurimit me kusht është një kontratë e vlefshme.
- b) Kontrata e dhurimit me kusht është një kontratë e pavlefshme.
- c) Kushti në kontratën e dhurimit konsiderohet i paqenë.
- d) Kontrata e dhurimit me kusht është pjesërisht e pavlefshme.

37. Si vëhet në vonesë debitori?

- a) Debitori duhet të vëhet në vonesë me anë të një kujtese noteriale.
- b) Nuk është e nevojshme vënia në vonesë e debitorit kur ka kaluar afati brenda të cilit duhet të ekzekutohej detyrimi.
- c) Dispozitat mbi vonesën zbatohen ndryshe për detyrimet që përmbajnë veprime, nga ato që përmbajnë mosveprime.
- d) Kur nga vonesa ka humbur interesi i kreditorit, vënia në vonesë mund të bëhet me gojë ose me shkrim.

38. A parashkruhet padia për kthimin e shumave të depozituara?

- a) Padia për kthimin e shumave të depozituara në bankë ngrihen në çdo kohë para institucionit financiar.
- b) Padia për kthimin e shumave të depozituara në bankë i nënshtrohet afateve të përgjithshme të parashkrimit.
- c) Padia për kthimin e shumave të depozituara në bankë parashkruhet me kalimin e pesë vjetëve.
- d) Padia për kthimin e shumave të depozituara në bankë nuk parashkruhet.

39. Kur shuhet dorëzania, pengu ose hipoteka?

- a) Dorëzania, pengu dhe hipoteka e kredisë fillestare shuhet përveç kur palët janë marrë vesh shprehimisht që ato të ruhen edhe për kredinë e re.
- b) Dorëzania, pengu dhe hipoteka e kredisë fillestare shuhet në rast se detyrimi kalon te një debitor i ri.
- c) Pengu ose hipoteka e dhënë nga debitori i mëparshëm mbeten në fuqi edhe për debitorin e ri.
- d) Detyrimet shuhet me përtëritje, kur palët me marrëveshje zëvendësojnë detyrimin fillestar, me një detyrim tjetër të ndryshëm nga i pari.



40. Kur mund ta falë personin e padenjë trashëgimlënësi?

- a) Trashëgimlënësi ka të drejtë ta falë personin e padenjë për ta trashëguar, me kusht që falja të bëhet shprehimisht me akt noterial ose me testament.
- b) Trashëgimlënësi ka të drejtë ta falë personin e padenjë për ta trashëguar, edhe kur trashëgimlënësi ka shënuar në një shkresë të thjeshtë se e ka njohur padenjësinë e megjithatë e cakton atë si trashëgimtar.
- c) Trashëgimlënësi ka të drejtë ta falë personin e padenjë për ta trashëguar me çdo lloj veprimi.
- d) Trashëgimlënësi ka të drejtë ta falë personin e padenjë me dëshmi me gojë në një proces gjyqësor.



RUBRIKA V

E DREJTA FAMILJARE DHE E DREJTA TREGTARE

TEZA 8

Rrethoni alternativën e saktë:

E DREJTA FAMILJARE

41. Njohja e amësisë së fëmijës së regjistruar me prindër të panjohur mund të bëhet edhe nga:

- a) kujdestari;
- b) nëna e mitur;
- c) trashëgimtarët e nënës;
- d) nëpunësi i gjendjes civile.

42. Pëlqimi për birësim:

- a) tërhiqet në çdo kohë.
- b) tërhiqet në çdo kohë, deri sa të jetë dhënë vendimi i gjykatës.
- c) tërhiqet vetëm brenda periudhës së provës.
- d) tërhiqet brenda 3 muajve nga dhënia e tij.

43. Ndryshimi i emrit/mbiemrit mund të bëhet:


- a) disa herë për shkak të papërshtatshmërisë;
- b) sa herë të vlerësohet e nevojshme;
- c) vetëm një herë;
- d) vetëm një herë dhe për shkak të papërshtatshmërisë.

44. Pëlqimi për lidhje martese para nëpunësit të gjendjes civile:

- a) Jepet nga kujdestari ose ushtruesi i përgjegjësishë prindërore të të miturit;
- b) Jepet nga nëpunësi për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve;
- c) Jepet nga vetë i mituri i autorizuar nga gjykata, edhe pse nuk ka zotësi për të vepruar;
- d) Jepet njëkohësisht nga i mituri dhe përfaqësuesi i tij/saj ligjor.

45. Përfaqësues procedural i të miturit në një proces gjyqësor në zbatim të ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" është:

- a) prindi i fëmijës;
- b) kujdestari i posaçëm i fëmijës;
- c) personi i caktuar nga autoriteti procedues nga lista e dërguar nga njësia për mbrojtjen e fëmijës;
- d) një i afërm i besuar i fëmijës.



E DREJTA TREGTARE

46. Në një shoqëri kolektive, përgjegjësia e ortakut para kreditorëve të shoqërisë është:

- a) përgjegjësi e kufizuar deri në vlerën e kontributeve në kapitalin e shoqërisë;
- b) përgjegjësi e pakufizuar;
- c) përgjegjësi sipas përcaktimeve në statut;
- d) përgjegjësi e kufizuar deri në pjesën e pashlyer të kontributeve në kapitalin e shoqërisë.

47. Largimi i një prej ortakëve të kufizuar në një shoqëri komandite sjell si pasojë:

- a) prishjen e shoqërisë komandite;
- b) likuidimin e shoqërisë komandite;
- c) ç'regjistrimin e shoqërisë;
- d) vazhdimin e veprimtarisë së saj si shoqëri tregtare.

48. Në një SHPK, ortakët e saj:

- a) mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë.
- b) nuk mbulojnë personalisht humbjet;
- c) mbulojnë humbjet deri në pjesën e pashlyer të kontributeve;
- d) përgjigjen në mënyrë solidare për humbjet e saj pa kufizime.

49. Shoqëria aksionare me ofertë private:

- a) nuk mund të ketë një kapital më të vogël se 3 500 000 lekë;
- b) duhet të ketë kapital mbi 2 000 000 lekë;
- c) nuk ka rëndësi kapitali;
- d) duhet të ketë kapital mbi 100 lekë.

50. Vendimi i Asamblesë së Përgjithshme të aksionarëve për prishjen e shoqërisë aksionare në gjendjen e aftësisë paguese ka si pasojë:

- a) hapjen e procedurave të likuidimit;
- b) hapjen e procedurave të falimentimit;
- c) ç'regjistrimin e menjëhershëm të shoqërisë;
- d) shpërndarjen nga administratori të pasurive të shoqërisë, ortakëve të saj.



RUBRIKA VI
E DREJTA E BE-SË
E DREJTA NDËRKOMBËTARE PUBLIKE
TEZA 1

LEGJISLACIONI I BE-SË

51. Dokumenti më i rëndësishëm i hartuar nga institucionet e BE-së për të drejtat e njeriut është:

- a) Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut;
- b) Akti Unik i të Drejtave të Njeriut;
- c) Karta e BE-së për të Drejtat Themelore;
- d) Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut.

52. Parlamenti merr pjesë në procesin legjislativ me të njëjtin pushtet si Këshilli në:

- a) Procedurën e bashkëpunimit;
- b) Procedurën e bashkëvendosjes;
- c) Procedurën e pranimi;
- d) Procedurën e këshillimit.

53. Deklarata e Robert Schuman në vitin 1950 ishte thirrje për të krijuar:

- a) Komunitetin Europian të Qymyrit dhe Çelikut;
- b) Komunitetin Ekonomik Europian;
- c) Komunitetin Europian të Energjisë Bërthamore;
- d) Komunitetin Ekonomik të Mbrojtjes.

54. Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian mund t'i drejtohet me kërkesë për vendim paragjykimor:

- a) Komisioni Europian;
- b) Këshilli Europian;
- c) Cilido person fizik/juridik i një shteti anëtar të Bashkimit Europian;
- d) Gjykatat e shteteve anëtare të Bashkimit Europian.

55. Përfaqësuesi i Lartë i BE-së për Politikën e Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë është njëkohësisht edhe:

- a) Zëvendëspresident i Komisionit Europian;
- b) Zëvendëspresident i Këshillit Europian;
- c) Sekretar i Përgjithshëm i Këshillit Europian;
- d) a+c.



E DREJTË NDËRKOMBËTARE PUBLIKE

56. Gjykata Ndërkombëtare për të Drejtën e Detit:

- a) Ka 21 anëtarë me mandat 9-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje;
- b) Ka 15 anëtarë me mandat 9-vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje;
- c) Ka 21 anëtarë me mandat 9-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje;
- d) Ka 15 anëtarë me mandat 9-vjeçar, pa të drejtë rizgjedhjeje.

57. Në zhvillimin e procesit në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë:

- a) Mund të caktohet gjyqtar *ad hoc* në çështjet gjyqësore midis shteteve;
- b) Duhet të caktohet një gjyqtar *ad hoc* në dhënien e çdo mendimi këshillimor;
- c) Duhet të caktohet një gjyqtar *ad hoc* kur trupi gjykues nuk është i plotë.
- d) b + c.

58. Vendimin mbi përkatësinë e arit monetar shqiptar të grabitur gjatë Luftës së Dytë Botërore e mori:

- a) Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë;
- b) Komisioni Trepalësh (SHBA, Britani e Madhe, Francë);
- c) Arbitri Ndërkombëtar;
- d) Tribunali Ndërkombëtar i Arit.

59. Regjim i kapitulacioneve quhet:

- a) Regjimi që zbatohet ndaj robërve të luftës;
- b) Regjimi që parashikonte të drejta dhe privilegje për fuqitë e mëdha në disa vende të tjera;
- c) Regjimi i dorëzimit pa kushte pas përfundimit të luftimeve;
- d) Regjimi që zbatohet gjatë armëpushimit.

60. Kaperizmi është:

- a) E drejta e sulmit ndaj anijeve tregtare gjatë luftimeve në det të hapur;
- b) Mundësia e angazhimit të anijeve tregtare në veprimet luftarake;
- c) E drejta e nëndetëseve për të kapur anijet e armikut në det të hapur;
- d) E drejta e kapjes së robërve të luftës.



RUBRIKA VII

HISTORIA E SË DREJTËS NË SHQIPËRI

Teza 2

Rrethoni pohimin e saktë:

61. Mbretëria e Arbërisë (Regnum Albaniae), e krijuar nga anzhuinët në çerekun e fundit të shekullit XIII, e kishte qendrën në:

- a) Shkodër;
- b) Ulqin;
- c) Berat;
- d) Durrës.

62. Mbretëria e Arbërisë (Regnum Albaniae) e krijuar nga anzhuinët në çerekun e fundit të shekullit XIII ishte:

- a) Shtojcë e Mbretërisë së Napolit;
- b) Shtojcë e Perandorisë së Serbisë;
- c) Formalisht njësi politike më vete;
- d) E pavarur në politikat që ndiqte dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare.

63. Sipas Statuteve të Shkodrës, pronësia nuk mund të fitohej me:

- a) Blerje;
- b) Trashëgimi;
- c) Parashkrim fitues;
- d) Grabitje.

64. Subjekt i Statuteve të Drishtit ishin:

- a) Vetëm klerikët dhe besimtarët e Kishës Katedrale të Drishtit;
- b) Klerikët dhe besimtarët e Kishës Katedrale të Drishtit dhe kishave të tjera katolike në varësi të saj;
- c) Vetëm klerikët e kishave ortodokse;
- d) Vetëm besimtarët e kishave ortodokse.

65. Në Perandorinë Osmane, kadiu:

- a) Kryente vetëm rolin e gjyqtarit;
- b) Kryente edhe funksione jashtëgjyqësore, përfshirë një funksion të ngjashëm me noterinë;
- c) Ushtronte funksionin në emër të *Sheh ul-Islam* (ndihmës kryesor i sulltanit për çështje fetare dhe juridike);
- d) Shqyrtonte vetëm çështje civile.



66. Gjatë pushtimit osman në Shqipëri kanë vepruar:

- a) Sheriati (ligji i shenjtë);
- b) Kanunametë (ligjet laike);
- c) Sistemi i Miletit (për popullsinë jo myslimane);
- d) Sheriati, Kanunametë dhe Sistemi i Miletit, paralelisht.

67. Në kuadër të autonomisë realizuar nga Lidhja e Prizrenit, shtetasit:

- a) Mund të zgjidhnin cilës gjykatë (osmane apo të Lidhjes) t'i drejtoheshin sipas besimit të tyre (në vilajetin e Kosovës);
- b) Mund t'i drejtoheshin vetëm gjykatës së Lidhjes (në vilajetin e Kosovës) dhe drejtimi drejt gjykatave osmane nuk lejohej;
- c) Nuk mund të paguanin taksat dhe tatimet në favor të organeve të Lidhjes;
- d) Nuk mund të refuzonin shërbimin ushtarak për Portën e Lartë dhe të regjistroheshin në repartet e Lidhjes për mbrojtjen e trojeve shqiptare.

68. Cili nga pohimet e mëposhtme është i vërtetë:

- a) Shpërthimi i Luftës Ballkanike në tetor të vitit 1912 ndikoi pozitivisht për çështjen shqiptare;
- b) Durrësi u pushtua nga trupat serbe më 28 nëntor 1912;
- c) Durrësi u pushtua nga trupat italiane më 28 nëntor 1912;
- d) Isa Boletini mbërriti në Vlorë më 27 nëntor 1912.

69. Sipas Statutit Themeltar të vitit 1925:

- a) Deputetët zgjidheshin nga e gjithë popullsia;
- b) Deputeti nuk përfaqësonte qarkun por kombin;
- c) Mandati i deputetit ishte 3-vjeçar;
- d) Pushteti legjislativ ushtrohej nga Parlamenti me një dhomë.

70. Sipas Statutit Themeltar të vitit 1925:

- a) Kryetari i Republikës nuk kishte të drejtë të shpallte gjendjen e jashtëzakonshme;
- b) Qeveria ishte organ ndihmës i Kryetarit të Republikës;
- c) Çdo vendim i Qeverisë duhet të kishte firmën e Kryetarit dhe nuk kundërfirmohej nga ministri përkatës;
- d) Kryetari i Republikës në veprimtarinë e tij nuk ishte i përgjegjshëm për tradhti të lartë.



76. Sinonimi i fjalës “adaptoj” në gjuhën shqipe është:

- a) Filloj;
- b) Përshtat;
- c) Prirem;
- d) Shpërdoroj.

77. Përcaktoni funksionin e fjalës së nënvizuar në fjalinë: “Ata i ishin afruar shtëpisë.”

- a) Kundrinor i drejtë;
- b) Kundrinor i zhdrejtë;
- c) Rrethanor vendi;
- d) Përcaktor.

78. Përcaktoni llojin e fjalisë: “Djali i vogël nuk lëvizi, por filloi të bënte shaka me më të rriturit.”:

- a) Nënrenditëse kushtore;
- b) Nënrenditëse qëllimore;
- c) Bashkërenditëse kundërshtuese;
- d) Bashkërenditëse shtuese.

79. Fjalitë: “Natë. Qielli i kthjellët me yje.”, janë fjali:

- a) Emërore;
- b) Pavetore;
- c) Të përbëra;
- d) Dykryegjymtyrëshe.

80. Në cilin rast është shkruar drejt ky emërtim?

- a) Ministri i Punëve të Jashtme;
- b) Ministri i Punëve të jashtëme;
- c) ministri i Punëve të jashtme;
- d) ministri i Punëve të Jashtme.



RUBRIKA IX
TESTI I INTELIGJENCËS

Teza 10

I. Rrethoni alternativën e saktë:

81. Nëse një vajzë është 21 vjeçe dhe ka gjysmën e moshës së mamasë së saj, sa vjeçe do të jetë mamaja e saj kur vajza do të jetë 42 vjeç?

- a) 84;
- b) 63;
- c) 42;
- d) 70;
- e) 68.

82. Nëse rezultati final i një ndeshje ka qenë 3-2, sa mënyra të ndryshme ka për rezultatin e pjesës së parë të saj?

- a) ---16---
- b) ---12---
- c) ---10---
- d) ---14---
- e) ---21---

83. Një autobus me ekskursionistë po udhëton për në Sarandë. $\frac{1}{3}$ anë gra, $\frac{1}{3}$ e $\frac{1}{2}$ së udhëtarëve janë fëmijë dhe pjesa tjetër janë burra. A mund të thoni se sa burra ka në autobus?

- a) 9--- burra;
- b) 6--- burra;
- c) 12--- burra;
- d) 14--- burra;
- e) 8---burra.

84. Një bandë muzikore prej 40 muzikantësh do 4 minuta të luajë një marsh. Sa kohë do të donte një bandë prej 60 muzikantësh?

- a) --5--
- b) --6--
- c) --3--
- d) --4--
- e) --2--

85. Çfarë konkluzioni mund të nxirret nga teksti origjinal pa pasur asnjë informacion tjetër shtesë?

Në qytetet tona, sulmet janë më të shpeshta gjatë natës sesa gjatë ditës.

- a) Është e zakonshme që kur është errësirë një kalimtar jo shumë dyshues të sulmohet.
- b) Ka më shumë sulme kur bëhet natë sepse është më errët.
- c) Probabiliteti për t'u sulmuar është më i lartë në qytet gjatë natës sesa gjatë ditës.
- d) Errësira favorizon sulmet.
- e) Fakti që rrugët janë më pak të frekuentuara favorizon një shtim të sulmeve.



86. Marta dhe Drini janë me pushime. Ata zbresin nga taksia dhe kanë ende 140 metra për të bërë para se të arrijnë tek treni. Siç ishte i ngarkuar me çanta, Drini nisët, ndërkohë që Marta paguan taksinë. Drini kishte ecur 15 m kur Marta e arrin atë. Pavarësisht ecjes që kishte bërë Drini, Marta kishte arritur tashmë në tren, ndërsa Drini kishte ende 20 metra për të bërë.

Sa është distanca shtesë e përshkuar nga Marta (në metra) në kohën kur Drini kishte ecur 3 metra?

- a) 1; b) 2; c) 3; d) 4; e) 5.

87. Tri fjalët e vendosura në ekuacionin e mësipërm si dhe fjala e katërt që ne na duhet të zgjedhim midis propozimeve a, b, c dhe d janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.

HUMB vs GJEJ -- HARROJ vs ?

- a) VJEN NË MENDJE; b) MENDOJ;
c) KËRKOJ; d) REFLEKTOJ.

88. Një ingranazh në një makinë ka një numër të caktuar dhëmbësh në të. Të gjitha dhëmbët janë të numërtuara në mënyrë të njëpasnjëshme nga njëshi e lart. Dhëmbi me numër 8 është ekzaktësisht i kundërt me dhëmbin që është numërtuar me numrin 20. Sa dhëmbë ka ingranazhi?

- a) 22;
b) 24;
c) 21;
d) 20.

89. Njëra nga fjalët nuk integrohet/përshtatet me tre të tjerat. Cila prej tyre?

- a) Gjueti;
b) Këmbëz pushke;
c) Qitje;
d) Plumb.

90. Florjani dhe Marjana po luajnë ndeshjen e tyre të 24-të të futbollit. Ekipet kanë barazuar dymbëdhjetë herë dhe skuadra e Marjanës ka fituar një të tretën e ndeshjeve të tjera. Sa ndeshje ka fituar skuadra e Florjanit ?

- a) 3; b) 4; c) 5; d) 6; e) 8.



RUBRIKA X

ETIKA PROFESIONALE

TEZA 6

I. Rrethoni alternativën e saktë:

91. Këshilltari për etikën gjyqësore caktohet nga:

- a) Nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Gjykatës së Faktit dhe që ka përvojë dhe njohuri mbi çështje të etikës;
- b) Nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Gjykatës së Apelit dhe që ka përvojë dhe njohuri mbi çështje të etikës;
- c) Nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Gjykatës së Lartë dhe që ka përvojë dhe njohuri mbi çështje të etikës;
- d) Nga radhët e gjyqtarëve që plotësojnë kushtet ligjore për të qenë anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe që ka përvojë dhe njohuri mbi çështje të etikës.

92. Gjyqtari kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, shkarkohet nga:

- a) Kryetari i Gjykatës së Lartë;
- b) Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- c) Ministri i Drejtësisë;
- d) Gjykata Kushtetuese.

93. Çfarë nuk i lejohet avokatit gjatë veprimtarisë:

- a) Avokati që punon më vete ose në partneritet nuk duhet të përfshihet në asnjë veprimtari tjetër nëse, duke vepruar kështu mund të cenohet pavarësia;
- b) Avokati ndalohet të formojë ortakëri me një person që nuk është avokat, në rast se veprimtaria e ortakërisë përbëhet nga ushtrimi i avokatisë;
- c) Avokati nuk duhet të ndihmojë një jo avokat, për të ushtruar një profesion jo të autorizuar;
- d) Të gjitha sa më sipër.

94. Kur Inspektori i Lartë i Drejtësisë kryen shkelje të rënda profesionale ose etike, shkarkohet nga:

- a) Gjykata e Lartë;
- b) Këshilli i Lartë Gjyqësor;
- c) Ministri i Drejtësisë;
- d) Gjykata Kushtetuese.

95. Si prokuror viheni në dijeni, se oficeri i policisë gjyqësore i ka thënë të dyshuarit në një prej hetimeve tuaja, që do t'ia mbyllin biznesin bashkëshortes për mospagim taksash, nëse ai nuk e pranon krimin. Sipas standardeve të etikës dhe rregullave të sjelljes, si duhet të sillët prokurori:

- a) I kushton kujdes çdo pretendimi të bërë për shkeljen e të drejtave të një subjekti të procedimit ose të një dëshmitari, duke përfshirë edhe pretendimet për keqtrajtim;



- b) Përmbush funksionet e tij duke shmangur çdo paragjykim dhe diskriminim ndaj subjekteve;
- c) Synon të shmangë situatat në të cilat individët mund të ndiejnë se po ndërmerret një qasje e njëanshme dhe i adreson këto situata në një mënyrë që të rritë besimin dhe respektin e publikut te prokuroria;
- d) Të gjitha sa më sipër.

96. Kur duhet që gjyqtari të refuzojë gjykimin e një çështjeje:

- a) Nëse mund të vihet në diskutim pavarësia e tij, pavarësisht nëse kjo kërkohet apo jo nga palët;
- b) Nëse ai çmon se nuk është në gjendje të gjykojë në mënyrë të paanshme;
- c) Nëse një vëzhguesi të arsyeshëm mund t'i krijohet përshtypja që ai nuk është në gjendje ta gjykojë çështjen në mënyrë të paanshme;
- d) Të gjitha sa më sipër.

97. Kur prokurori kërkon dhe pranon dhurata, hua preferenciale apo favore për vete ose anëtarët e familjes së tij, që i vijnë për shkak të ushtrimit të detyrës, kemi:

- a) Vlerësim;
- b) Mirënjohje;
- c) Korrupsion;
- d) Respekt.

98. Cilat janë shkaqet e arsyeshme kur avokati mund të tërhiqet nga një përfaqësim:

- a) Pandershmëria e arsyeve të klientit për të kërkuar asistencë ligjore;
- b) Klienti insiston që avokati të ndërmarrë veprime të cilat janë në kundërshtim me ligjin ose me Kodin e Etikës;
- c) Klienti insiston që avokati të ndërmarrë veprime që janë në kundërshtim me vlerësimin e tij profesional;
- d) Të gjitha sa më sipër.

99. Këshilltari për Etikën gjyqësore shërben:

- a) Për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë;
- b) Për një periudhë 4-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë;
- c) Për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë;
- d) Për një periudhë 6-vjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje vetëm një herë.

100. Ndodheni në gjykimin e një rasti mjaft të komplikuar ku zëvendësoni kolegun tuaj, i cili ndodhet jashtë për kurim. Kolegu ka akuzuar një person për një vepër, cilësimi juridik i së cilës nuk i përgjigjet përshkrimit faktik dhe nuk mbështetet me prova. Në gjykim vërejtjet dhe kritikrat drejtohen te ty si prokuror, pasi përfaqësoni akuzën në këtë rast. Si duhet të veproni si prokuror?

- a) Të vazhdoni procesin pa reaguari;
- b) Të tregoni se kush e ka bërë atë gabim;
- c) Të thoni se ju kurrë nuk do të kishit konkluduar ashtu;
- d) Të përmirësoni gabimin, gjatë seancave dhe fjalës përfundimtare pa përmendur kolegun tuaj.

